



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS / TUŽILAČKI SAVET KOSOVA / KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 4 paragrafi 1.27 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 14 qershor 2017, nxjerrë këtë:

### UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.02/2017

#### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.02/2016 PËR PËRDORIMIN E TELEFONAVE FIKS DHE MOBIL NË KËSHILLIN PROKURORIAL DHE PROKURORITË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

##### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është plotësimi dhe ndryshimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2016 për përdorimin e telefonave fiks dhe mobil në Këshillin Prokurorial dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës.

##### Neni 2

Neni 2 i Udhëzimit Administrativ bazë riformulohet me tekstin si në vijim:

- a) Kryeprokurori i Shtetit;
- b) Kryesuesi i Këshillit;
- c) Zëvendëskryeprokurori i Shtetit;
- d) Zëvendëskryesuesi i Këshillit;
- e) Anëtarët jo prokurorë të Këshillit;
- f) Kryesuesit e komisioneve të përhershme;
- g) Prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
- h) Kryeprokurorët e prokurorive të Kosovës;
- i) Prokurorët e prokurorive të Kosovës;
- j) Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik;
- k) Drejtori i Sekretariatit të Këshillit;
- l) Drejtori i Njësitit për Shqyrtimin e Përfomancës së Prokurorisë;
- m) Udhëheqësit e njërive organizative të Këshillit dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
- n) Administratorët e prokurorive të Kosovës, dhe
- o) Zyrtarët e kabinetit të kryeprokurorit të Shtetit.

### Neni 3

#### Shpenzimet për telefonat mobil me kartelë mbushëse (prepaid)

Neni 5 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ bazë riformulohet me tekstin si në vijim:

- |   |                 |
|---|-----------------|
| a) Kryeprokurori i Shtetit  | deri në 100.00€ |
| b) Kryesuesi i Këshillit  | deri në 100.00€ |
| c) Zëvendës Kryeprokurori i Shtetit   | deri në 30.00€  |
| d) Zëvendës Kryesuesi i Këshilli  | deri në 30.00€  |
| e) Ish Kryeprokurori i Shtetit  | deri në 100.00€ |
| f) Prokurorët e ZKPSH   | deri në 30.00€  |
| g) Anëtarët jo prokuror të Këshillit  | deri në 20.00€  |
| h) Kryesuesit e komisioneve të përhershme të Këshillit  | deri në 30.00€  |
| i) Kryeprokurori PSRK   | deri në 30.00€  |
| j) Kryeprokurori i PA   | deri në 25.00€  |
| k) Kryeprokurorët e PTH   | deri në 25.00€  |
| l) Kryeprokurori i PTH Prishtinë  | deri në 30.00€  |
| m) Prokurorët e prokurorive të Kosovës  | deri në 20.00€  |
| n) Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik   | deri në 50.00€  |
| o) Stafi i zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik   | deri në 20.00€  |
| p) Drejtori i Sekretariatit   | deri në 60.00€  |
| q) Drejtori i NjSHPP  | deri në 30.00€  |
| r) Këshilltarët   | deri në 20.00€  |
| s) Administratorët  | deri në 15.00€  |
| t) Udhëheqësi i Departamentit në SKPK   | deri në 20.00€  |
| u) Menaxheri i Zyrës në ZKPSH dhe NJSHPP  | deri në 15.00€  |
| v) Udhëheqësi i Divizionit në SKPK  | deri në 15.00€  |
| w) Udhëheqësi i Zyrës në SKPK   | deri në 10.00€  |
| x) Zëdhënësi  | deri në 15.00€  |
| y) Asistentët KPSH, Kryesues, Drejtor SKPK dhe NJSHPP   | deri në 10.00€  |
| z) Zyrtari për regjistrimin dhe protokollimin e urdhëresave të pranuar në Njësinë Ndërlidhëse   | deri në 20.00€  |
| aa) Zyrtarët tjerë të sistemit prokurorial, sipas nenit 2 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2016 për përdorimin e telefonave fiks dhe mobil në Këshillin Prokurorial dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës. |                 |

### Neni 4

#### Shpenzimet mujore për telefon fiks

I. Neni 7 i Udhëzimit Administrativ bazë riformulohet me tekstin si në vijim:

- |                                     |                       |
|-------------------------------------|-----------------------|
| a) Kryesuesi i Këshillit            | sipas nevojës zyrtare |
| b) Kryeprokurori i Shtetit          | sipas nevojës zyrtare |
| c) Zëvendës kryeprokurori i Shtetit | deri në 50.00€        |
| d) Ish Kryeprokurori i Shtetit      | deri në 20.00€        |
| e) Prokurorët e ZKPSH               | deri në 20.00€        |
| f) Kryeprokurori i PSRK             | deri në 30.00€        |
| g) Prokurorët e PSRK                | deri në 20.00€        |

h) Kryeprokurori i PA	deri në 30.00€
i) Prokurorët e PA	deri në 20.00€
j) Kryeprokurorët e PTH	deri në 30.00€
k) Prokurorët e PTH	deri në 20.00€
l) Drejtori i Sekretariatit	deri në 50.00€
m) Drejtori i NJSHPP	deri në 30.00€
n) Këshilltarët	deri në 20.00€
o) Udhëheqësi i Departamentit në SKPK	deri në 20.00€
p) Udhëheqësi i Zyrës në NJSHPP dhe ZKPSH	deri në 15.00€
q) Administratorët	deri në 15.00€
r) Udhëheqësi i Divizionit në SKPK	deri në 10.00€
s) Udhëheqësi i Zyrës në SKPK	deri në 10.00€
t) Zëdhënësi	deri në 15.00€
u) Asistentët KPSH, Kryesues, Drejtor SKPK dhe NJSHPP	deri në 15.00€

II. Çdo zyrë në kuadër të sistemit prokurorial mund të ketë vetëm një telefon fiks, shpenzimet e të cilit nuk mund të kalojnë vlerën e caktuar në paragrafin I të këtij neni.

III. Zyrtarët e cekur në paragrafin I të këtij neni, në rast se tejkalojnë shpenzimet mujore të parapara për telefon fiks, duhet të deklarojnë dhe të arsyetojnë shpenzimet përmes një formulari të veçantë.

#### **Neni 5**

#### **Procedura e pajisjes me telefon fiks**

Neni 8 i Udhëzimit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

- I. Udhëheqësit i njësisë organizative, mund të bëjë kërkesë të drejtori i Sekretariatit për pajisje me telefon fiks të zyrtarit të sistemit prokurorial të Kosovës, me kërkesë të veçantë dhe të arsyetuar.
- II. Në rastin kur drejtori i Sekretariatit miraton kërkesën për pajisje me telefon fiks të zyrtarit të sistemit prokurorial të Kosovës, vlera e shpenzimeve do të jetë deri në 10.00 € në muaj.

#### **Neni 6**

Neni 9 i Udhëzimit Administrativ fjalia Zyra për Teknologji Informative (TI), zëvendësohet me Departamenti për Teknologji Informative.

#### **Neni 7**

Neni 11 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ fjalia Zyra për TI, zëvendësohet me Departamenti për Teknologji Informative.


**Neni 8  
Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Vendimi KPK/469/2016 dhe Vendimi Nr. Prot. DSKPK-197/2016.

**Neni 9  
Hyrja në fuqi**

Udhëzimi Administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, më 14 qershor 2017

Blerim Isufaj  
  
Kryesuesi  
Këshillit Prokurorial të Kosovës

